



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 414, datë 10.10.2022

PËR

NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT KORÇË, Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 10.10.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...}”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatorja e procedurës së përzgjedhjes znj. Marçela Shehu,

V Ë R E N:

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si Këshilli) pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji¹, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër të tjera, ka hapur dhe një procedurë ngritjeje në detyrë edhe në Gjykatën Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, me Vendimin e saj nr. 132, datë 01.04.2021.

¹ Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar;

Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”;

Vendimi nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”;

Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

2. Pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 132, datë 01.04.2021, aplikoi një kandidat, konkretisht z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, aktualisht gjyqtar i skemës së delegimit i caktuar për një periudhë kohe në Gjykatën e Apelit Korçë.

3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësisimit, në rastin konkret për të vetmin kandidat, të kriterëve të mëposhtme:

- 1) “përvojës profesionale minimale”, sipas shkronjës “b”, pika 4, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “4. *Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “8. *Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “1. *Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e kësaj neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e saj deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cënuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të kësaj neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efënca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të kësaj neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të kësaj neni. ...”;*

- 4) *të pasurisë dhe figurës*, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të kësaj ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

5. Kështu, për kandidatin e vetëm, z. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit dhe me Vendimin nr. 353, datë 09.09.2021, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

6. Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatin kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

- 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin;
- 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019.

Kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin në këtë rast, përveç se një detyrim ligjor, ndërsa ai nuk kishte asnjë vlerësim të tillë, është vlerësuar e domodoshme për sa kohë ai kandidonte për ngritjen në detyrë, ku një vlerësim në nivelin e përgjithshëm “i pamjaftueshëm”, pra një vlerësim etik dhe profesional me cilësi të dobët, jo vetëm nuk do të përlligjte ngritjen në detyrë, por, përkundrazi, referuar pikës 6, të nenit 95, të Ligjit për Statusin, do të përbënte shkas për dërgimin e raportit të vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar fillimin e hetimit dhe, më tej, të procedimit disiplinor ndaj kandidatit, duke vënë kështu në diskutim nga ana tjetër, plotësimin e kriterëve të kandidimit prej tij. Një rrethanë e tillë në rastin konkret lidhet veçanërisht me vlerësimin e përshpejtuar të kandidatit për vitin 2019, ndërsa sa i përkte vlerësimit me qëllim gradimin për periudhën e rivlerësimit kalimtar, një moment i tillë është i tejkaluar sa kohë kandidati ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka, referuar përcaktimit të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59, të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, presupozon se kandidati ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra se ai është vlerësuar “I aftë”, pra që ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe se ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në shkronjën “a”, të nenit 44, të këtij ligji.

7. Me kualifikimin e kandidatit z. {...}, bazuar në pikën 24, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), Këshilli, me Vendimin nr. 391, datë 22.09.2021, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 132, datë 01.04.2021. Me këtë vendim, si relatore e

procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Marçela Shehu.

8. Më datë 22.09.2021, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit 70/2020, kandidati i kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatores. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesë për përjashtimin e relatores apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

9. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit 70/2020, relatorja administroi dokumentacionin përkatës të kandidatit, që gjendej në dosjen e tij personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësisimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatorja administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për të.

10. Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatin e vetëm z. {...} u konstatua se:

- a) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 163, datë 05.05.2022, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 377 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim;
- b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 150, datë 14.04.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

11. Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatit z. {...} të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 163, datë 05.05.2022 dhe nr. 150, datë 14.04.2022, u konstatua të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim, referuar informacionit të ardhur në Këshill nga Gjykata Administrative e Apelit në rrugë elektronike me datë 17.06.2022.

12. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, u përgatit projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 380, datë 19.09.2022 ka vendosur :

1. *Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
1) Z. {...}*
2. *Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.*
3. *Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.*

14. Ky vendim rezulton jetë përfundimtar pasi ndaj tij nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit të dërguar në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me nr. 4865/4 akti, datë 04.10.2022, përmes të cilës është shprehur se pasi u njoh me vendimin e arsytuar të Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tij.

15. Në kushtet kur Vendimi i Këshillit nr. 380, datë 19.09.2022 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” tashmë është përfundimtar dhe i vendim i formës së prerë, në zbatim të pikës 68, të Vendimit 70/2020, është përgatitur projektvendimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 132, datë 01.04.2021.

II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

16. Projektvendimi “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...}”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Kreu VIII, të Vendimit 70/2020.

17. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatorja, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar në funksion të procedurës së renditjes.

III. KONKLUZIONI

18. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...}”.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 132, datë 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 15.10.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR